

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Verdikti i Hagës për krerët e UÇK-së, BE mesazh rajonit: Respektoni vendimet, ndihmoni në shërimin e plagëve të së kaluarës
ADRESA	https://www.gazetatema.net/rajoni/verdikti-i-hages-per-kreret-e-uk-se-be-mesazh-rajonit-respektoni-vendimet-i586958
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 18:05:29 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 18:00:02 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	ee397a64c9bba36f4ccf4f834fa182425e766ef7cd5ad1cde00432e3f67ea8e5
TEKSTI	295418bdee068361fd3e61ed3959f5ac46c8bb0628cf004e09d690297eee38c3
PAMJA	973073a0059d679a35bff590f3d4842558080712b8f4a6e8bf79611385d322d4

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	c70d5fd742e7e5c7c69371f92213e4ab3acc4c1f13ea89dd70e5b56ed4c53408
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0188b89a08595528a7763f43617734e52df4cad134485b32e03065e5637ea5a1
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/c70d5fd742e7e5c7c69371f92213e4ab3acc4c1f13ea89dd70e5b56ed4c53408

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English



1 e [Verdikt i Hagës për krerët e UÇK-së, BE mesazh rajonit: Respektoni vendimet, ndihmoni në shërimin e plagëve të së kaluarës](#) fundit

Verdikt i Hagës për krerët e UÇK-së, BE mesazh rajonit: Respektoni vendimet, ndihmoni në shërimin e plagëve të së kaluarës



18 Shtator 2026, 20:00Rajoni TEMA



Bashkimi Evropian u ka bërë thirrje vendeve të rajonit të respektojnë vendimet e Dhomave të Specializuara të Kosovës dhe të kontribuojnë në procesin e pajtimit, pas aktgjyqimit të shkallës së parë ndaj katër ish-drejtnesve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Zëdhënësi i Komisionit Evropian për Punë të Jashtme dhe Politikën e Sigurisë, Christian Wigand, tha se Dhomat e Specializuara zhvillojnë procedura gjyqësore të drejta, të paanshme dhe të pavarura, të bazuara në parimin e përgjegjësisë individuale penale.

“Shikoni, ajo që mund të them për këtë çështje është se Bashkimi Evropian merr shënim aktgjyqimin e shkallës së parë në çështjen e Prokurorisë së Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit. Dhomat e Specializuara të Kosovës japin drejtësi duke zhvilluar procedura gjyqësore të drejta, të paanshme dhe të pavarura, të bazuara në parimin e përgjegjësisë individuale penale. Personat e dënuar, natyrisht, kanë të drejtë të apelojnë aktgjykimin para gjyqtarëve të pavarur të apelit, në një trup gjyqësor të veçantë të shkallës së apelit. BE-ja u bën thirrje të gjitha palëve dhe aktorëve në Kosovë dhe në rajon që të tregojnë përmbytje”, tha Wigand.

Në të njëjtën linjë u shpreh edhe zëdhënësi i Komisionit Evropian për Zgjerim, Guillaume Mercier

“Dhomat e Specializuara të Kosovës janë një organ gjyqësor i paanshëm dhe i pavarur. Aktgjykimet e tyre duhen të respektohen dhe personat e dënuar kanë të drejtë të apelojnë. Kjo ka të bëjë me përgjegjësinë individuale dhe drejtësinë për viktimat dhe familjet e tyre nga të gjitha komunitetet në Kosovë. Ne u bëjmë thirrje aktorëve në rajon që të ndihmojnë në shërimin e plagëve të së kaluarës. Vetëm përmes pajtimit vendet e rajonit mund t'i tejkalojnë ndarjet dhe të ecin përpara drejt një të ardhmeje të përbashkët, drejt Bashkimit Evropian”, deklaroi ai.

Reagimi i Komisionit Evropian vjen pas vendimit të shkallës së parë të Gjykatës Speciale, e cila më 16 shtator dënoi Hashim Thaçin dhe Jakup Krasniqin me nga 25 vjet burg, Kadri Veselin me 18 vjet dhe Rexhep Selimin me 13 vjet.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, e cilësoi atë një padrejtësi, ndërsa kryeministri Edi Rama e quajti vendimin “marre”.



Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Christopher Hill për dënimin e ish-krerëve të UÇK-së: Thaçi, nuk është përfshirë në krime apo vepra të paligjshme](#)

19:00 Rajoni / 2 komente

["U fajësuan viktimat", Nurellari: Gjykata Speciale nuk i është përmbajtur ligjit](#)

18:40 Rajoni / 2 komente

[Zgjedhjet në Serbi, OSBE e gatshme të mbledhë votat në Kosovë, por pret miratimin e institucioneve vendase](#)

17:50 Rajoni / 1 koment

[Top Poll: Zhgënjim i madh i shqiptarëve nga Gjykata e Hagës](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.